

## **Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Saint-Louis, Bruksel, Belgjikë**

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Saint-Louis, Bruksel, Belgjikë për semestrin e dytë të vitit akademik 2017-2018.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (3 muaj);
- PhD (3 muaj)

### **Fushat e studimit:**

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti Saint-Louis klikoni në adresën:

<http://www.usaintlouis.be/sl/977.html>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

✓ Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

-CV (në gjuhën angleze/franceze);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti;

-Listë notash (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/franceze);

-Letër Motivimi (në gjuhën angleze/franceze);

-Certifikatë e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Frëngjisht sipas programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saint-Louis lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.*

*Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)*

✓ Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin **Doktoraturë**:

- CV (në gjuhën angleze/franceze);

- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studenti;

- Diplomë Bachelor;

- Listë notash Bachelor;
- Diplomë Master (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/franceze);
- Listë notash Master (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/franceze);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/franceze);
- Certifikata e gjuhës së huaj B1 (Anglisht/Frëngjisht sipas programit të studimit)

- Dokumeti Learning Agreement\*

*\* Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Saint-Louis lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës. Nëse ju nuk do të frektoni lëndë dhe nuk do të merrni kredite në universitetin pritës por do të shkoni vetëm për hulumtim atëherë duhet ta përcaktoni këtë gjë në dokumentin e Learning Agreement.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)*

Afati për aplikim: **10 Nëntor 2017**

Dokumentat duhen dorzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si edhe të skanuara përmes postës elektronike në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!